

Për:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal, z.Bexhet Kuçi Kryetarin e Komunës, z.Bali Muharremaj
Nga:	Grupi i Grave të Kuvendit - Suharekë Sanie Kuqi Rexhepaj – Kryetare e GGK _____
Lënda:	Kërkesë për pikë të rendit të ditës në mbledhjen e rregullt të III-të të Asamblesë për vitin 2024

Të nderuar,

Si Grupi i Grave të Kuvendit jemi të përkushtuar në mbështetjen e vazhdueshme dhe fuqizimin e grave përmes mekanizmave të ndryshëm.

Duke parë nga afër statistikat rreth regjistrimit të pronës së paluajtshme, konkretisht legalizimit të ndërtimeve pa leje, janë shqetësuese numrat se sa ndërtime janë legalizuar në bashkëpronësi (burrë dhe grua), e sa vetëm në emër të grave.

Nga të dhënat e ofruara nga Drejtoria për Shërbime Pronësore, Juridike dhe Kadastër:

Ndërtime të legalizuara në bashkëpronësi (burrë dhe grua)	1
Ndërtime të legalizuara në emër të grave	16

Vetëm një shtëpi është legalizuar në pronësi të përbashkët që nga viti 2019, kurse 16 ndërtime janë legalizuar në emër të grave, nga gjithsej....ndërtime të legalizuara.

Duke e parë gjendjen si të tillë, ne Grupi i Grave të Kuvendit, e kemi parë të arsyeshme të propozojmë masa afirmative që mund të ndikojnë në rritjen e këtyre shifrave.

Si Grup, duke u mbështetur në Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, propozojmë që:

Taksa për legalizimin e ndërtimeve të kategorisë së I-rë dhe shtëpitë e kategorisë së II-të të lirohen nga taksa e Legalizimit:

1. Aplikuesit në pronësi të përbashkët (burrë dhe grua) dhe
2. Aplikueset (gratë)

Andaj, kërkojmë që ky propozim të inkuadrohet si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e III-të të rregullt të Asamblesë Komunale për vitin 2024.

GGK, ju falënderon paraprakisht për bashkëpunim!

Me respekt,

Sanie Kuqi Rexhepaj

Kryetare e Grupit të Grave